



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:160105

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05684591

C. nr. 669/2020

Gjykata Themelore Gjilan – Degë në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, më bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: S. L.dhe M.L., të dy nga të cilët me autorizim i përfaqëson Avni Leci, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigma”, më seli në Prishtinë, Rr.”Edmond Hoxha”, nr.27, të cilën me autorizim e përfaqëson Yll Musa, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, me vlerë të kontestit prej 8,645.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datën 29.04.2024 mori, ndërsa më datën 13.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. Apropohet pjesërisht si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësve: S.L. dhe M.L., të dy nga dhe Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigma”, më seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, që iu ka shkaktuar paditësve: Sali Leci dhe Mihrije Leci, më datën 30.07.2020, në Kamenicë, në aksidentin e komunikacionit, t’ia paguaj, shumat si në vijim:

Në emër të dëmit jo material për paditësin S. L.:

- Për dhimbjet e përjetuara fizike – trupore, shumën prej 800.00 (tetëqind) euro,
- Për dhimbje shpirtërore, për friken e përjetuar shumën prej 500.00 (pesëqind) euro,

Në emër të dëmit jo material për paditësen M. L.:

- Për dhimbjet e përjetuara fizike – trupore, shumën prej 800.00 (tetëqind) euro,
- Për dhimbje shpirtërore, për friken e përjetuar shumën prej 500.00 (pesëqind) euro,

Në emër të dëmit material:

- Për shpenzimet e shërimit, shumën prej 65.00 euro.

II. Detyrohet e paditura KS “SIGMA”, me seli në Prishtinë, që t’ia paguaj shumat e gjykuara paditësve: S. L. dhe M. L., të dy nga si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamat ligjore prej 8%, nga dita 13.05.2024, si datë e përpilimit të aktgjykimit e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditëve, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, S. L., nga në shumë të përgjithshme prej 2 960 euro, shumë kjo përtej shumave të gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e kërkuar në emër të kompensimit të dëmit jo material respektivisht e kërkuar në emër të dhimbjeve fizike-trupore, në emër të dhimbjeve shpirtërore për frikën e përjetuar dhe kompensimit të dëmit material, ndihmën nga personi tjetër, ushqimit të përforcuar, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 30.07.2020, duke iu shkaktuar lëndime të lehta trupore, **TËRËSISHT E PABAZUAR.**

IV. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, M.L., nga, në shumë të përgjithshme prej 3 020 €, shumë kjo përtej shumave të gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e kërkuar në emër të kompensimit të dëmit jo material respektivisht e kërkuar në emër të dhimbjeve fizike-trupore, në emër të dhimbjeve shpirtërore për frikën e përjetuar dhe kompensimit të dëmit material, ndihmën nga personi tjetër, ushqimit të përforcuar, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 30.07.2020, duke iu shkaktuar lëndime të lehta trupore, **TËRËSISHT E PABAZUAR.**

V. Detyrohen paditësit që ta paguajnë taksën gjyqësore për padi në shumë prej 60.00 euro.

VI. Detyrohet e paditura, që paditësve t’ia kompensojnë shpenzimet e procedurës, në shumë të përgjithshme prej 1,121.60 euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim. Ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës të kërkuara, në shumë prej 156.00 euro, refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

1. Rrjedha e procedurës

Paditësit S.L. dhe M. L., të dy nga Kamenica, përmes të autorizuarit të tyre A.L., avokat nga Prishtina, më datë 10.11.2020, në këtë gjykatë, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGMA”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Yll Musa, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti për kompensimin e dëmit material dhe jo material, me vlerë të kontestit për padi, në shumë prej 2,500.00 euro. Ne padi ka theksuar se me dt.30.07.2020, ne rrugën “....., me fajin e vozitësit të siguruar te e paditura, ka ndodhur deri te aksidenti i komunikacionit, duke mos iu përshtatur shpejtësisë së lëvizjes , kushteve dhe rrethanave në rrugë dhe nga pakujdesia humb kontrollin mbi automjetin e tij dhe del ne shiritin e kundërt të lëvizjes, ku me pjesën e majtë të automjetit godet në pjesën e cepit të majtë të automjetin e markës “.....” me targa, të cilin ishte duke e drejtuar vozitësi , tani paditësi Sali Leci, ku si pasojë e aksidentit të trafikut pësojnë lëndime paditësi S. L. ne cilësinë e vozitësit dhe paditësja M.L., në cilësinë e pasagjeres në automjetin e markës golf, ku me pastaj kërkojnë ndihmë mjekësore në QKMF në Kamenicës, e më pas paditësja M.L., është dërguar në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, ku si pasoj e aksidentit doktorët konstatojnë se si pasoj e aksidentit ka pasur lëndime ne kokë, qafë, gjoks si dhe në pjesët tjera të trupit.

2. Pretendimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i paditësve në padi dhe në seancat e mbajtura ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar për format e demit jo material dhe material dhe në shumat e precizuar me parashtrësën e datës 13.02.2024, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësve t’ia kompensoj dëmin që e kanë pësuar si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit dt.30.07.2020, dhe atë për paditësin e parë, për dëmin jo material edhe atë për dhembjet trupore, shumën prej 2.000 €, për frikën e pësuar, shumën prej 2.000 €, , ndërsa për dëmin material, edhe atë për ndihmën dhe kujdesin e personit të huaj, për një ditë, shumën prej 20 euro, dhe në emër të ushqimit të përforcuar, për 12 ditë shumën prej 240 euro, ndërsa për paditësen e dytë, ne emër të dëmit material edhe atë për dhembjet trupore, shumën prej 2.000 €, për frikën e pësuar, shumën prej 2.000 €, , ndërsa për dëmin material, edhe atë për ndihmën dhe kujdesin e personit të huaj, për një ditë, shumën prej 20 euro, dhe në emër të ushqimit të përforcuar, për 15 ditë shumën prej 300 euro, dhe në emër të shpenzimeve të shërimit, shumën prej 65 euro. Nga arsyet e paraqitura i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovoj si në shumat e precizuara me parashtrësën e datës

13.02.2024. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 1,277.60 euro, edhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 156 euro, për pagesën e taksës gjyqësore, shumë prej 60 euro, për përpilimin e parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë, shumë prej 156.00 euro, për përfaqësim në dy seanca gjyqësore, shumë prej nga 202.80 euro, këto në shumë prej 405.60 euro, për pagesën e ekspertizës mjekësore nga lëmia e ortopedisë , shumë prej 250 euro dhe për pagesën e ekspertizës nga lëmia e psikiatrisë shumë prej 250 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës, ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve në seancat e kaluara duke theksuar se nuk e kontestojnë bazën juridike të kërkesëpadisë, lidhur me aksidentin e dt.30.07.2020, dhe se kontestuese mbeten shumat në precizimin e kërkesëpadisë, shuma këto tejet të larta, në kundërshtim me masat dhe kriteret për vlerësimin e dëmit material dhe jo material, e cila është në kundërshtim edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor të caktuar nga gjykata, ku është konstatuar se kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore, pa kurrfarë pasoja, dhe se shumat e kërkuara kalojnë satisfaksionin real për këto lloj të dëmeve të cilat janë në kundërshtim edhe me Mendimin e Gjykatës Supreme, për kompensimin e dëmeve, po ashtu ka theksuar se e kundërshtojnë kërkesën për shpenzimet e procedurës , duke u bazuar në parimin e suksesit në procedurë ketë sipas nenit 452 pika 2, të LPK-së, si dhe faktin se të zbatohet vendimi i gjykatës për pagesën e ekspertëve si dhe kamata ligjore për demin jo material të vendoset nga dita e marrjes së aktgjykimit, ngase në procedurë administrative kanë dhënë ofertën tonë në shumë prej nga 1,000.00 euro, për secilin paditës për të gjitha format e dëmit, si satisfaksion real për lëndimet e pësuar në këtë aksident të komunikacionit. Nga arsyet e paraqitura ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësve për shumat e kërkuara ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimi i mbajtur në këtë gjykatë me dt.29.04.2024, bëri administrimin e provave me leximin e raportit të aksidentit i hartuar nga policia, nr. 2020-CA-315, i datës 30.07.2020, si dhe skica e vendit të ngjarjes, si dhe të gjitha provat mjekësore të bashkëngjitur padisë si dhe të cekurat në ekspertizën mjekësore, vlerësimi mjekësor i dt.04.12.2023, në emër të paditësve S.L.dhe M. L..

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga këto arsye.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë meqë i autorizuari i palës së paditur asnjëherë nuk e ka kontestuar, madje palëve paditëse në procedurë administrative i ka bërë ofertë për arritjen e marrëveshjes, mirëpo kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë të precizuar me parashtrësën e datës 13.02.2024.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësve në cilësinë e provës materiale, ka nxjerr ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr.Vjollca Binçe, eksperte e ortopedisë dhe Dr.Samire Braina, eksperte e psikiatrisë, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësve, kanë dhënë mendimin profesional, përmes ekspertizës së punuar me shkrim dt.06.12.2023, ku sipas tyre paditësi S.L., nuk ka pasur dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë, dhimbje të intensitetit të rëndë ka përjetuar në kohëzgjatje në 24 orë të para deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve, dhimbje të intensitetit të mesëm ka pasur për 12 ditë dhe të tjera dhe kryesisht në regjionin e trupit për shkak të ndrydhjeve, dhimbje të intensitetit të ulët ka pasur për 14 ditë tjera kohë pas kohe, ndërsa frikë primare ka pasur në momentin e aksidentit e përjetuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimin direkt për integritetin trupor e cila ka zgjatur për disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë, e cila ka zgjatur për 48 orë, frikë sekondare të intensitetit mesatar ka pasur në kohëzgjatje prej 3 muaj, frikë sekondare të intensitetit të ulët ka pasur e cila ka zgjatur për 3 muaj të tjerë, zvogëlim te aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur, nuk ekziston shëmtimi trupor, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 12 ditë edhe atë me ushqim të pasur me proteina, minerale, vitaminë me shumë se ushqimi i zakonshëm, ndihma edhe kujdesi nga personi tjetër ka qenë e nevojshme për 24 orët e para të aksidentit dhe rehabilitimi klimatik dhe psikofizik nuk ka qenë i nevojshëm. Ndërsa sipas ekspertëve të lartë cekur, për të paditurën e dytë M. L., e njejta dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë nuk ka pasur, dhimbje të intensitetit të rëndë ka përjetuar në kohëzgjatje në 24 orë të para deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve, dhimbje të intensitetit të mesëm ka pasur për 15 ditë dhe të tjera dhe kryesisht në regjionin e trupit për shkak të ndrydhjeve, dhimbje të intensitetit të ulët ka pasur për 15 ditë tjera kohë pas kohe ku edhe tani ka dhimbje të kohë pas kohëshme në lëvizje të qafës, ndërsa frikë primare ka pasur në momentin e aksidentit e përjetuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimin direkt për integritetin trupor e cila ka zgjatur për disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë, e cila ka zgjatur për 48 orë, frikë sekondare të intensitetit mesatar dhe më të ulët, ka pasur në kohëzgjatje prej 3 muaj deri në 4 muaj, zvogëlim te aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur, nuk ekziston

shëmtimi trupor, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 15 ditë edhe atë me ushqim të pasur me proteina, minerale, vitaminë me shumë se ushqimi i zakonshëm, ndihma edhe kujdesi nga personi tjetër ka qenë e nevojshme për 4 ditë, rehabilitimi klimatik dhe psikofizik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 7 ditë, për forcimin e muskujve të qafës.

Ekspertizën e lartpërmendurë gjykata e mori në tërësi të bazuara dhe ia dha besimin e plotë, këtë nga se ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi se e paditura mbanë përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësve me rastin e lëndimeve gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditësve t'ia kompensoi dëmin me që shkaktuesi i dëmit ka lidhur kontratë me të paditurën KS “SIGMA”, dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësisë komfor nenit 159 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Me dispozitën e nenit 182 dhe 183 të LMD-se janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbjet e pësuar fizike, për frikën e pësuar etj. Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësve, moshën e tyre, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata miratohet të kërkesëpadinë e paditësve në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke vlerësuar si shpërblime real, objektive dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin jo material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Gjykata duke u bazuar në nenin 169 të LMD-së, në të cilin është parapara kompensimi i dëmit material, ka aprovuar në tërësi kompensimin e dëmit material për paditësen e dytë edhe atë për shpenzimet e shërimit, ngase të njëjtat shpenzime janë të dëshmuara me prova materiale edhe atë përmes 3 kuponëve fiskal, shpenzime këto të shkaktuara për shërimin, rrjedhimisht shpenzimet e shërimit, të cilën shumë gjykata e aprovoi si në pikën I të dispozitivit.

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 7, të LPK-së, ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, si dhe në dispozitën e nenit 319, paragrafi 1, të LPK-së, ku përcaktohet se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, gjykata vendosi sikurse në pikën III dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase në mungesë të provave materiale relevante, erdhi në përfundim se pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit të parë, e kërkuar në emër të dëmit material në shumë të përgjithshme prej 260 €, për ndihmën dhe kujdesin e huaj, në shumën prej 20 € dhe për ushqim të përforcuar shumën prej 240 €, si dhe për paditësen e dytë, e kërkuar në emër të dëmit material në shumë të përgjithshme prej 320 €, për ndihmën dhe kujdesin e huaj, në shumën prej 20 € dhe për ushqim të përforcuar, në shumën prej 300 €, duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar, pasi që palët paditëse fillimisht nuk kanë arritur që t’i prezantojnë gjykatës prova konkrete rreth këtyre shpenzimeve të cilat të njëjtit i kanë kërkuar që t’iu kompensohen, e as gjatë shqyrtimit kryesor nuk kanë arritur që t’i provojnë pretendimet e tyre, se të njëjtëve iu kanë shkaktuar edhe këto shpenzime.

Gjykata konsideron se shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuarat të paditësve në aksidentin e komunikacionit, lëndimit dhe pasojave duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve, standardin jetësor të qytetareve të Kosovës, si dhe Udhëzuesin nr.41/2023, të dt.27.02.2023, për Caktimin e Kriereve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Dëmit të Drejtë në të Holla të Dëmit Jo material, të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 382 të LMD-së, si dhe Mendimit juridik nr.265/2020, të dt.02.12.2020, të Gjykatës Supreme të Kosovës, për kamatën ligjore.

Gjykata, në bazë të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, dhe nenit 253.4 të LPK-së, i ka detyruar palët paditëse që ta paguajnë taksën gjyqësore për padi në shumë prej 60.00 euro, sipas vlerës së kontestit.

Gjykata, lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore vendosi duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1, të LPK-së, si dhe në bazë të Tarifës të Odës të Avokatëve të Kosovës,

dhe e detyroj të paditurën, që paditësve, t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 1,121.60 euro. Shpenzime këto të shkaktuara si në vijim; dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumë prej 156.00 euro, në emër të pagesës së taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë, shumë prej 60 euro, në emër të ekspertizës mjekësore të psikiatrisë shumë prej 250.00 euro, në emër të ekspertizës mjekësore të ortopedisë, shumë prej 250.00 euro, në emër të përfaqësimit në 2 (dy) seanca gjyqësore, shumë prej 405.60 euro.

Ndërsa gjykata, pjesën tjetër të shpenzimeve të procedurës edhe atë për përpilimin e parashtrës për precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej nga 156.00 euro, e refuzoi si të pa bazuar nga fakti se përfaqësuesi i paditësit precizimin e padisë ka mundur ta bëjë në shqyrtimin gjyqësor të caktuar pas pranimit të ekspertizave përkatëse.

Duke u bazuar në thëniet dhe dispozitat materiale të lartcekura, si dhe në dispozitën e nenit 143 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:160105, 13.05.2024**

Gjyqtarja,
Valbonë Dërvodeli, d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.